



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
KËSHILLI TEKNIK

Nr. 180 Prot.

Tiranë, më datë 11.06.2024

VENDIM
Nr. 6, datë 11.06.2024

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, si dhe në Vendimin e KKTKM-së, Nr. 27 datë 19.02.2020 “Për miratimin e llojeve të ndërhyrjeve me karakter mirëmbajtës të pasurive kulturore, sipas listës bashkëlidhur”, pas shqyrtimit të projektit, në mbledhjen e datës 11.06.2024, Këshilli Teknik:

VENDOSI:

- Miratimin e projektit “*Vijimi i fazës së dytë i projektit “Parku Arkeologjik Amantia”, sistemime elementesh arkitektonike dhe pastrime dherash në godinën antike tek “Qafa e Pazarit” në Parkun Arkeologjik të Amantias, me aplikues dhe zhvillues DRTK Vlorë, me rekomandimin;*
 - Të realizohet pastrimi nga vegjetacioni dhe nga dherat e depozituara përgjatë viteve;
 - Sistemimi dhe lëvizja e blloqeve antike, të realizohet mbi bazën e një studimi dhe si projekt i veçantë.
- Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
- Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi;
- Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

